6. Lidhur me automjetin, tip "Ford Focus". i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rrem në lidhje me mënyrën e shlyerjes dhe burimin që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti. ii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur huan e marr nga z. B. Ç, hua e cila ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti në deklaratën "Vetting". iii. Subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe ka kryer deklarim të rrem. iv. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë financiare nga burime të ligjshme në shumën - 1.998.185 lekë, në vitin 2011, që ka blerë këtë automjet

7. Për aksionet, "Bono Privatizimi". i. Subjekti i rivlerësimit është në situatën e konfliktit të interesit.

8. Lidhur me vlerën prej 1.100.000 lekësh likuiditet në cash gjendje. i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të këtyre të ardhurave. ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare nga burime të ligjshme për të justifikuar të ardhurat e dërguara nga djali i subjektit, në shumën prej 10.000 UDS.

9. Lidhur me banesën me sipërfaqe 60 m2 , në të cilën subjekti banon aktualisht, ndodhur në Tiranë. i. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë këtë pasuri duke e regjistruar në emër të personit tjetë të lidhur/znj. M. Sh.

10. Për të ardhurat e personit të lidhur/djalit të subjektit. i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur/djalit të subjektit, për pagimin e kredisë së blerjes së makinës në shumë prej 64.000 USD, sipas kësteve të pagesës. ii. Personi i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për të shlyer këstet e 40 kredisë financiare të automjetit, tip "Toyota Camy", si dhe shumën prej 15.000 USD për pagesën e shkollës së personit të lidhur/vajzës së subjektit.

11. Për të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/vajzës së subjektit të rivlerësimit – A. D. i. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur bursën e përfituar për periudhën 2012, 2013 në vlerën 22.500 USD. ii. Subjekti i rivlerësimit ka deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e financimit të studimeve të vajzës. iii. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të rremë shpenzimet e kryera për shkollimin e vajzës. iv. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur shumën reale të shkollimit të vajzës, ku sipas dokumentacionit rezultoi shuma prej 8.721.836,651 lekësh, ndërkohë që subjekti ka deklaruar vetëm shumën prej 5.128.950 lekësh.

12. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën "Vetting" të vitit 2017. i. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor të ardhurat në

Ishqiptarja.com

shumën prej 5.175.400 lekësh (si diferencë e të ardhurave të deklaruara në shumën 36.848.148 lekë me shumë e të ardhurave me dokumentacion justifikues ligjor shumën prej 31.672.748 lekësh)

13. Për analizimin financiar të deklarimeve ndër vite të subjekti të rivlerësimit. i. Subjekti i rivlerësimit ka deklarime të pasakta, ka fshehur dhe ka kryer deklarim të rremë ndër vite pranë ILDKPKI-së. Rezultatet e rivlerësimit të pasurisë: Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, referuar nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Luan Dervishi, rezultoi se : Ka pasur deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me germa "a", pika 5, nenitϖ 33, të ligjit nr. 84/2016. Nuk ka pasur burime të ligjshme për justifikimin e pasurive, bazuar te germa "b", pika 5,ϖ neni 33, të ligjit nr. 84/2016. Ka kryer fshehje pasurie, bazuar te germa "c", pika 5, neni 33, të ligjit nr. 84/2016.ϖ Ka pasur deklarim të rremë, bazuar te germa "c", pika 5, neni 33, të ligjit nr. 84/2016.ϖ Ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, bazuar te germa "a", pika 5, neni 33, të ligjitϖ nr. 84/2016. a. Në lidhje me Kontrollin e Figurës, Komisioni arrin në konkluzionin se: Subjekti ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës b. Për Vlerësimin Profesional, Komisioni arrin në përfundimin se:

14. Subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mungesë të aftësive organizative të një gjyqtari. 41

15. Përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni që disponon nga Ministria e Drejtësisë dhe faktet e bëra publike në media dhe shqyrtimi i pavarur i këtij rasti në tërësinë e tij, janë të pamjaftueshme për t'u konsideruar si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, por ato merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5, e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e brendshme vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar si dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z***. Luan Dervishi***, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

Ishqiptaria.com

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 26.11.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
Firdes SHULI Kryesues
Pamela QIRKO Etleda ÇIFTJA Anëtare Relatore
Anisa DUKA Sekretare gjyqësore

==========

6-Z.Shkelzen Selimi, ishe Gjyqtare në Gjykatën e Larte Tirane,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
Nr. 54 Akti Nr.52 Vendimi Tiranë, më 30.07.2018
V E N D I M
Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga
Etleda Çiftja Kryesuese
Valbona Sanxhaktari Relatore Xhensila Pine Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, zotit John LEONARDO,më datë 23 qershore 2018, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori ne shqyrtim ne i seancën dëgjimore publike mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. **Shkelzen Selimi**, gjyqtar pranë Gjykatës së Larte.

OBJEKTI: Rivlerësimit kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet,A Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;miratuar ne ligjin,nr,76.date 22.07.2016"Per disa shtesa

[shqiptarja.com]

dhe ndryshime ne ligjin nr.8417,date,21.10.1998,Kushtetuta e Republikes Shqiperise e ndryshuar.

1. Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
3. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KONKLUZIONET PERFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit te Pavarur te Kualifikimit,pasi u njoh me rrethanat e ceshtjes,bazuar ne provat e administruara,raportet dhe rekomandimet e relatorit te ceshtjes,zhvilloi seancen degjimore publike,ku subjketi i rivlersimit vendosi te mos qendroje per te degjuar dhe dhene shpjegime,lidhur me rezultatet e hetimit,si dhe mori ne shqyrtim te gjitha pretendimet dhe provat e administruara nga subjketi i rivlersimit,konstaton se subjketi nuk ka arritur nivelin e besueshem te kontrollit te figures

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Komisioni te Pavarur te Kualifikimit, bazuar në nenin 5 pika 55 të ligjit nr. 84/2016,pasi u mblodhe ne dhome keshillimi,ne prani te vezhguesit nmderkombetare,ne baze te nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,neni 4 pika 2,58,pika 1,germa’c’si dhe nenit 61,pika 2 dhe 3,te ligjit nr.84/2016,per rivlersimin kalimtare te Gjyqtarve dhe Prokurorve te Republikes Shqiperise .

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit z. **Shkelzen Selimi**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe Vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelimit nga subjektet e interesuara, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë më 30.07.2019.

TRUPI GJYKUES

Etleda Çiftja Kryesuese
Valbona Sanxhaktari Relatore Xhensila Pine Anëtare

[shqiptaria.com]

7-Z.Gani Dizdari, ishe Gjyqtare në Gjykatën ne Gjykaten Kushtetuese te Shqiperise Tirane,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI I PAVARUAR I KUALIFIKIMIT
NR. 6 AKTI NR. 37 VENDIMI Tiranë, më 16.07.2018
V E N D I M
Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:
Pamela Qirko Kryesuese
Olsi Komici Anëtar Roland Ilia Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 12.07.2018, ora 12:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. **Gani Dizdari**, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, përfaqësuar me prokurë nga avokat Sokol Hazizaj.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, C, D, DH, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, (referuar më poshtë Kushtetuta); Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016); Ligji nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë"; Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Përfundime lidhur me vlerësimin pasuror.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e pasurive: Apartament banimi,• 40 me sipërfaqe 69.7 m², ndodhur në adresën: Rr. "***", Pl. ***, Shk. ***, Ap. ***, Tiranë, ZK. ***, nr. pasurisë ***, Vol. ***, Fq. ***; 40 Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëngjitur Deklaratës-Vetting: 21

Ishqiptaria.com

Depozitë në shumën 5.272 euro;• Shuma 23.000 euro, e dhënë nga z. G.L. (ish-bashkëshorti i znj. A.D.);• Shuma 36.000 euro, hua nga z. Sh.D.;• Shuma 20.000 euro, hua nga z. M.L.;• 5 këste në shumën prej 600 eurosh, qira nga z. M.D.;• 14 këste në shumën prej 500 eurosh, qira nga shoqëria "***" sh.p.k;• Shuma 15.000 euro, shpenzime për mobilimin e apartamentit;• Autoveturë e blerë për shumën 900.000 lekë (nëntëqind mijë).• Për sa më sipër, nga konstatimet e Komisionit, përbën deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe shkak ligjor për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. B. **VLERËSIMI I FIGURËS**:Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, me nr. *** prot., datë 07.05.2018, nr. *** prot., datë 11.05.2018, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari. Hetimi i kryer nga Komisioni: Nga hetimi i zhvilluar nga Komisioni ka rezultuar se, subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me shtetasin A.L./B. Z. A.L. cilësohet si person i përfshirë në krimin e organizuar, sepse sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. ***, datë 22.06.2012, është dënuar me vendim të formës së prerë41, për veprën penale të: "Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga neni 245/1 paragrafi 2 i Kodit Penal, vepër e cila të kualifikon si person të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 42 dhe nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale43 . Ka rezultuar nga hetimi administrativ, që ndikimin e paligjshëm, z. A.L., e ka ushtruar ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë, në periudhën kur subjekti i rivlerësimit, z. Gani Kontratë shitblerje, nr. *** rep., *** kol., datë 09.02.1998, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m², blerë nga znj. D.D., në• shumën 1.850.000 lekë; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 06.03.2007, "Për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë";• Vërtetim lëshuar nga ZVRPP-së Tiranë, me nr. *** prot., datë 07.12.2016;• Certifikatë për vërtetim pronësie datë 05.06.2007, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m².• 41Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 08.04.2014, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me nr. ***, datë 22.06.2012. 42 Neni 3, pika 15, ligji nr. 84/2016. 15. "Person i përfshirë në krimin e organizuar" është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë." 43 Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, gjykon: a) Krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e. 22 Dizdari, ushtronte funksionin e gjyqtarit pranë kësaj gjykate. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore, ka rezultuar që z. A.L., është dënuar për ndikim të paligjshëm ndaj vetë subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i raporteve të sistemit TIMS, ka rezultuar se, subjekti i rivlerësimit ka kaluar kufirin 10 herë me automjetin me targë

shqiptaria.com

***, për periudhën 06.05.2013 - 14.07.2017. Sipas shkresës së DPSHTRsë 44 me nr. *** prot., datë 12.01.2018, informohet se automjeti me targë ***, është në pronësi të shtetasit A.Q.B./L. Nga vlerësimi i sistemit TIMS ka rezultuar se me automjetin në pronësi të z. A. L. ka udhëtuar 10 herë dhe më shumë se me çdo automjet tjetër. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit z. Gani Dizdari, është pyetur me pyetësorin e dërguar me email-in e datës 13.03.2018, me përmbajtje: "Çfarë marrëdhënie keni me personat A.L. ... .? Tregoni sa të shpeshta janë takimet tuaja me këta persona? Ju lutem, specifikoni a keni udhëtuar ndonjëherë jashtë kufirit me këta persona? Nëse po, sa herë dhe me çfarë qëllimi?" Subjekti në përgjigjen e ardhur me shkresën, nr. *** prot., datë 19.03.2018, informon se: "Z. A.L. e kam nip, djalë motre. Me të kam marrëdhënie të mira, kam pasur dhe kam takime jo vetëm në raste familjare por dhe në takime të veçanta sipas rastit. Me z. A.L. kam udhëtuar, jashtë shtetit në Hamburg - Gjermani, fillimisht në vitin 2010 kur kam shkuar për ndërhyrje shëndetësore e më vonë dhe 2 - 3 herë të tjera, po për arsye shëndetësore mbasi kam pasur detyrim të bëj kontroll mjekësor për çdo vit. Theksoj se, fakti që kam shkuar me nipin tim, z. A.L., është se ai ka jetuar rreth 15 vite në Hamburg - Gjermani". Kjo lidhje e ngushtë që subjekti ka me këtë person, përbën rrethanë që merret parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm45në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket rrethanave lehtësuese, ato mungojnë sepse marrëdhënia familjare midis personave të mësipërm nuk është e largët dhe kontaktet familjare nuk janë të rralla. Nisur nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari, ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Kjo përbën një problem serioz me figurën, që bën të pamundur vazhdimin e detyrës dhe konstituon shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra46 .

PËR KËTO ARSYE:

Shih në dosje shkresën e Komisionit me nr. *** prot., datë 03.01.2018, drejtuar DPSHTR-së, me të cilën është kërkuar informacion për automjetet me të cilat ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit. 45 Neni 38, pika 4, shkronja "ç ", të ligjit nr. 84/2016 4. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar: ç) Subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; 46 Neni 61, pika 2, ligji nr. 84/2016. Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 2. "Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës". 23 Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa "c", si dhe të nenit 61, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë":

V E N D O S I:

Shqiptaria.com

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. *Gani Dizdari*, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
U shpall në Tiranë, më datë 16.07.2018.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Relator Kryesues
Anëtar Roland ILIA Pamela Qirko Olsi Komici
Sekretare Gjyqësore Olsida Goxhaj

8-Z.Artan Zeneli, ishe Gjyqtare në Gjykatën e Larte Tirane,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
NR. 12 AKTI NR. 41 VENDIMI Tiranë, më 18.07.2018
V E N D I M
Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:
Etleda Çiftja Kryesuese
Xhensila Pine Relatore
Valbona Sanxhaktari Anëtare
në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, më datë 16.07.2018, ora 13:00, zhvilloi në katin e dytë të Pallatit të Koncerteve seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

[shqiptarja.com]

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. **Artan Zeneli**, gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.
OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.
BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit:

Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se: (i) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës. (ii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për pasurinë. Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Nuh Zeneli, nuk arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë pasi: ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë; nga kontrolli i pasurisë u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht; u evidentua se ai ka ndërmarrë hapa për të fshehur, ose ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi, posedim ose përdorim të tij. Në zbatim të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës ndaj tij zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet e provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë rezultateve të hetimit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se: (i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë, bazuar në pikën 2 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e germës "g" të kreut V "Të dhëna për sigurinë", si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. 22 (iii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe deklarim të rremë në Deklaratën-Vetting, për burimin e krijimit te këtyre pasurive. (iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë. PËR KËTO ARSYE, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, DH, Ë

Ishqiptarja.com

të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 58, pika 1/ c dhe nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. **Artan Zeneli**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 18.07.2018.

Kryesuese Etleda ÇIFTJA
Anëtare / Kundër Relatore Valbona SANXHAKTARI Xhensila PINE
Sekretare gjyqësore Anisa DUKA

9-Z.Edmond Islamaj, ishe Gjyqtare në Gjykatën e Larte Tirane,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
Nr. 53 Akti Nr 22 vendimi date Tirane me 07.06.2018

V E N D I M
Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:
Suela Zhegu Kryesuese
Pamela Qirko Anëtare Genta Tafa (Bungo) Anëtare

Ishqiptaria.com

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj.Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 05.06.2018, ora 10:00,në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Edmond Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Lartë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE;Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (referuar më poshtë "Kushtetuta)

a. Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (referuar më poshtë "Ligji nr. 84/2016");
b. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
c. Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa "a", si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, Z. Edmond Islamaj, gjyqtar në Gjykatën e Lartë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimi tnga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.

Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 07.06.2018.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE SUELA ZHEGU Kryesuese PAMELA QIRKO GENTA TAFA (BUNGO) Anëtare Relatore.

Shenim: **Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit te Pavarur te Apelimit vlerëson se subjekti i vlerësimit ka kryer deklarim të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij. Për këto arsye, trupi gjykues vendosi: ndryshimin e vendimit numër 22, datë 7/6/2018 dhe shkarkimin nga detyra të zotit Edmond Islamaj.**

Ishqiptarja.com

10-Z.Guxim Zenelaj, ishe Gjyqtare në Gjykatën e Larte Tirane,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE.
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
Nr. 291 Akti Nr. 174 Vendimi Tiranë më 1. 7. 2019
V E N D I M
Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:
Pamela Qirko Kryesuese Firdes Shuli Relatore Olsi Komici Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, në datën 1 korrik 2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. ***Guxim Zenelaj***, anëtar i Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni "G" i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin "G" të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Guxim Zenelaj, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Shqiptaria.com

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 1.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela Qirko Kryesuese Olsi Komici Firdes Shuli Anëtar Relatore.

***Shenim**: Pasuritë e çmendura të gjyqtarëve, Guxim Zenelaj pronar i 18 apartamenteve brenda viti:Anëtarët e institucioneve më të larta të drejtësisë shqiptare vijojnë të befasojnë me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, brenda një viti kalendarik, konkretisht brenda vitit 2016. Anëtari i Gjykatës së Lartë, Guxim Zenelaj, gjatë vitit 2016, ka deklaruar në deklaratën e pasurisë 18 apartamente të reja dhe tre njësi ndërtimore në Ishull Shëngjin, Lezhë. Si burim për krijimin e pasurive të paluajtshme, gjyqtari referon një kontratë me një kompani të caktuar, por nuk ka të dhëna se sa është vlera e kontratës si dhe për burimin e parave që mbulojnë vlerën e kontratës.Sipas deklaratës së pasurisë që po publikon **Shqiptarja.com**, apartamentet janë me sipërfaqe: **292** m2, **62** m2, **67** m2, **54** m2, **60** m2, **51** m2, **54** m2, **66** m2, **59** m2, **55** m2, **54** m2, **55** m2, **67** m2, **51** m2, **54** m2, **55** m2 etj. Anëtari i Gjykatës së Lartë, Guxim Zenelaj, për vitin 2016, deklaron edhe tre pasuri e paluajtshme, njësi në Ishull Shëngjin, Lezhë, me sipërfaqe 16 m2, 15 m2 dhe 218.06 m2.*

Ai thotë se ka dy sipërfaqe trualli 1941 m2, në Ishull Shëngjin. Gjyqtari sqaron se vlera e blerjes së truallit është 16 000 euro. Këto para burojnë nga pjesa e shitjes së shtëpisë në Rr. Don Bosko, me vlerë 55 mijë euro. Po gjatë viti 2016, gjyqtari deklaron 30 mijë euro të ardhura nga dhënia me qira e një lokali dhe ambienteve për banim në Shëngjin.

11-Z.Marina Rraboshta, ishe Gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkoder,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 306 Akti Nr. 236 Vendimi Tiranë, më 6.2.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

[shqiptarja.com]

Lulzim Hamitaj Kryesues
Genta Tafa (Bungo) RelatoreSuela Zhegu Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 6.2.2020 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Marina Rraboshta, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";Ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese:

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërise.

V E N D O S I:

1-Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Marina Rraboshta, është ndërprerë.
2-Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3-Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivler ësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4-Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5-Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 6.2.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES
Lulzim HAMITAJ
Kryesues
Genta TAFA (BUNGO) Suela ZHEGU
Relatore Anëtare
Sekretare gjyqësoreFiorela Mandro

[shqiptarja.com]

12-Z.Besnik Imeraj, ishe Gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkoder,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
Nr. 3 Akti Nr.1 Vendimi Tiranë, më 8.2.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:
Brunilda Bekteshi Kryesues
Genta Tafa (Bungo) Anëtare *Etleda ÇIFTJA* Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj,pas shortimit te shperndarjes se ceshtjes dhe caktimit te kryetarit dhe relatorit,sot ne daten,08.2.2018,ora 14.00.ne sallen nr.2.te Selise Komisionit te Pavarur te Kualifikimit mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:
SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z.**Besnik Imeraj**.Anetare i Gjykates Kushtetuese te Republikes Shqiperise.
BAZA LIGJORE: Neni G i Aneksit te Kushtetutes se republikes Shqiperise.

- Neni 127 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Neni 14 dhe 15 te Ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
- Neni,9/1,c,te ligjit 8577,date,10.02.2000"Per funksionimin dhe organizimin e Gjykates Kushtetuese te Republikes Shqiperise,i ndryshuar ne ligjin,99/2016,dhe vendimi nr.78, te Gjykates Kushtetuese te Republikes Shqiperise.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

Ishqiptaria.com

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar te Anetarit te Gjykates Kushtetuese z.**Besnik Imeraj**, është ndërprerë.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit te rivlersimit z.Besnik Imeraj,Komisionierit Publik,dhe Operacionit Nderkombetare te Monitorimit.
3. Ankimi kundër këtij vendimi duhet t'i drejtohet Kolegjit te Posaçëm të Apelimit nga subjketi i rivlersimit dhe/ose Komisionierit Publik,15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit dhe duhet te dorzohet prane Komisionit te Pavarur te Kualifikimit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 6.2.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda Bekteshi KryesuesGenta Tafa (Bungo) Anëtare *Etleda ÇIFTJA*

Relatore asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj

---

13-Z.Aleksander Muskaj, ishe Gjyqtare në Gjykatën e Larte Tirane,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE.
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
Nr. 288 Akti Nr. 179 Vendimi Tiranë, më 10.7.2019
V E N D I M Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:
Etleda Çiftja Kryesuese
Valbona Sanxhaktari Anëtare Xhensila Pine Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 10.7.2019, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. **Aleksandër Muskaj**, ish-gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni "G" i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

Ishqiptarja.com

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Aleksandër Muskaj, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet: subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 10.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES
Etleda Çiftja Kryesuese
Valbona Sanxhaktari Xhensila Pine Anëtare Relatore Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj

14-Z.Petrit Fusha, ishe Drejtues i Prokurorise Tirane,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
NR. 134 Vendimi Tiranë, më 04.04.2019
V E N D I M
Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

[shqiptaria.com]

Lulzim Hamitaj Kryesues
Olsi Komici Relator Valbona Sanxhaktari Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, pas shortimit të shpërndarjes së çështjes, caktimit të kryetarit dhe relatorit, më datë 04.04.2018, ora 14:00, në sallën nr. 1, të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit: **SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT**:Z. **Petrit Fusha**, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni "G" i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

1. Nenet 14 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
2. Neni 64, pika 1, germa "a" dhe neni 65 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
3. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin "G" të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. **Petrit Fusha**, është ndërprerë.

2. Të deklarojë humbjen e së drejtës për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, më datë 04.04.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES
Lulzim Hamitaj Kryesues
Olsi Komici Valbona Sanxhaktari Relator Anëtare Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

15-Z.Besnik Cani, ishe Drejtues i Prokurorise Elbasan,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te:

[shqiptarja.com]

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Fshehje e te ardhurave.parashikuar nga neni 180,Kodit Penal.
4. Mospagimi i taksave dhe tatimeve.parashikuar nga neni 181,i Kodit Penal.
5. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
6. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni 257/a,Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 31 Akti Nr. 84 Vendimi Tiranë, më 27.11.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici Kryesues Lulzim Hamitaj Relator Brunilda Bekteshi Anëtare asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në Tiranë, më datë 23 nëntor 2018, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Besnik Cani, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan - pa përfaqësues.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika KPK - Vendim mbi subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Cani 31 1, germa "a" dhe nenit 59,

shqiptaria.com

pika 1, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Në zbatim të pikës 4 nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë disa çështje/praktika pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, si më poshtë vijon: a. Praktika e marrëdhënies juridiko-civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me shoqërinë "(***)" sh.p.k.; b. Çështja me nr. 1380, të vitit 2006, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; c. Dosja e procedimit penal me nr. 1079, të vitit 2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pa strehë, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 14, datë 28.03.2013; d. Çështja me nr. (***), të vitit 2015, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 27.11.2018. KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT Olsi Komici Kryesues Lulzim Hamitaj Brunilda Bekteshi Relator Anëtare Sekretare gjyqësore Denisa Kosta.

Shenim**:** ***Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit te Pavarur te Apelimit vlerëson se subjekti i vlerësimit ka kryer deklarim të paplotë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij. Për këto arsye, trupi gjykues vendosi: ndryshimin e vendimit nr.84, datë 27/22/2018 te KPK.me vendimin e dates 27.01.2020,te KPA shkarkimin nga detyra të zotit Besnik Cani.***

16-Besim Trezhnjeva,ishe Gjytare Gjykata e Apelit Durres,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni257/a i Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE.

Ishqiptaria.com

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
Nr. 14 Akti Nr. 14 Vendimi Tiranë më 13.04.2018
V E N D I M
Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:
Alma Faskaj Kryesuese
Roland Ilia Anëtar Firdes Shuli Relatore

me sekretare gjyqësore Znj. Ina Serjanaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datat 11 prill 2018, ora 11:00 dhe 13 prill 2018, ora 09:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKT I RIVLERËSIMIT : Z. Besim Trezhnjeva, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, përfaqësuar nga avokati Fatmir Braka, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. licence 120.

OBJEKTI : Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit

BAZA LIGJORE : Neni 179/b, dhe nenet A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar;

1. Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
2. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
3. Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Referuar Aneksit të Kushtetutës, neni D i saj, që parashikon "Vlerësimin e pasurive", ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", lidhur me kriterin e pasurisë, trupa gjykuese konkludon se për subjektin e rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, kanë rezultuar të vërtetuara : deklarime të pasakta (neni 33, pika 5/a, i ligjit);¬ mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë ne shumen prej¬ 20.133.368 lekësh (neni 33 pika 5/b, i ligjit); fshehje pasurie (neni 33, pika 5/c, i ligjit);¬ deklarime të rreme (neni 33, pika 5/ç, i ligjit).¬ Bazuar në këto konkulzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupa gjykuese konkludon se subjekti i rivlerësimit, Ka deklarime të pamjafueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë (neni 61/3 i ligjit),\ Ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë (neni 61/5),\ dhe atij duhet t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. PËR KËTO ARSYE,

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, nenet A, Ç, D, Ë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në nenin 58, pika 1, germa "c" dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

Ishqiptarja.com

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas pikës 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4- Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 13.04.2018.

Alma FASKAJ Kryesuese

Roland ILIA Firdes SHULI Anëtar Relatore Sekretare gjyqësore Ina Serjanaj

---

17-Arjan Balliu,ishe Gjyqtare Gjykata e Apelit Durres,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni257/a i Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 197 Akti Nr. 211 Vendimi Tiranë, më 18.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine Kryesuese

Valbona Sanxhaktari Anëtare Roland Ilia Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, në datën 6.11.2019, ora 14:00 dhe datën 11.11.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Arjan Balliu, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

Ishqiptaria.com

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar";

1. Ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
2. Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
3. Ligji nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në njërin prej kritereve të vlerësimit, atë të pasurisë, në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti e rivlerësimit, z. Arjan Balliu: - ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1991 – 2016; - ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për të ardhurat; - ka bërë deklarim të pasaktë dhe të rremë lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm; - ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016; - nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe personave të lidhur, në kuptim të nenin D, të Aneksit të Kushtetutës; - është gjendur në situatën e konfliktit të interesit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare dhe në bazë të germës "c", të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arjan Balliu, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.11.2019.

Shqiptaria.com

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES Xhensila PINE Kryesues Valbona SANXHAKTARI Anëtar Roland ILIA Relator Gledis Hajdini Sekretare gjyqësore

18-Ferdinand Elezi,ishe Drejtues i Prokurorise se Apelit Durres,i dyshuar per kryerjen e veprave penale te

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni257/a i Kodit Penal.

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
V E N D I M

Nr. 84 Akti Nr. 138 Vendimi Tiranë, më 09.04.2019
Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:
Firdes Shuli Kryesuese
Lulzim Hamitaj Relator Olsi Komici Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 29 mars 2019, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:
SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Ferdinand Elezi, prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, pa përfaqësues.
OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.
BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

1. Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
2. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë
3. Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

Në konkluzion, duke mbajtur parasysh që:

A- Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse, burimin e ligjshëm të disa të ardhurave, lidhur me shumat e specifikuara më sipër, sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Ismipiaria.com

B- Në lidhje me kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës "b", të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, dhe për rrjedhojë, për sa i përket figurës, ai konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C- Në lidhje me aftësitë profesionale subjekti i rivlerësimit arrin, së paku, nivelin minimal kualifikues, të kërkuar sipas germës "c", të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel besueshmërie, për sa i përket vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të germës "a", të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016,"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës "c", të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ferdinand Elezi, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. 3.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
5. Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 09.04.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT Firdes Shuli Kryesuese
Lulzim Hamitaj Olsi Komici Relator Anëtar Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

19-Ema Gashi,ishe Gjyqtare Gjykata e rrethit Durres,e dyshuar per kryerjen e veprave penale te

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.

Ishqiptaria.com

3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni257/a i Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT
V E N D I M
Nr. Akti Nr. 198 Vendimi Tiranë, më 8.10.2019
Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:
Lulzim Hamitaj Kryesues Pamela Qirko Anëtare Etleda Çiftja Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në datën 8.10.2019, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT: Znj. Ema Gashi, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

BAZA LIGJORE: Neni "G" i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë".

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin "G", të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Ema Gashi.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Ema Gashi si gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Shqiptaria.com

Ky vendim u shpall, në datën 8.10.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES Lulzim HAMITAJ Kryesues Pamela QIRKO Etleda ÇIFTJA Anëtare Relatore Olsida GOXHAJ Sekretare gjyqësore

---

20-. Besa Nikëhasani,ishe drejtuese e Prokurorise Apelit Shkoder,e dyshuar per kryerjen e veprave penale te

1. Mashtrimit.parashikuar nga neni 143.K.Penal.
2. Fshehja e pasurise.parashikuar nga neni 143/a/6.Kodit Penal.
3. Shperdorim detyre.parashikuar nga neni 248 i kodit Penal.
4. Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi irremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim parashikuar nga neni257/a i Kodit Penal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 30 AKTI NR. 15 VENDIMI Tiranë, më 20.4.2018

VENDIM

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Suela Zhegu Kryesuese

Pamela Qirko Anëtare Genta Tafa (Bungo) Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore Znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Znj. Mia LHE Roessingh-Bakels, më datë 17.04.2018, ora 11:00, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj.**Besa Nikëhasani**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit, Shkodër, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE : Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (referuar më poshtë Kushtetuta).

1. Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);
2. Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
3. Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Ishqiptaria.com

Subjekti i rivlerësimit, Besa Rexhep Nikëhasani, rezulton se ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sepse:

➔ Deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Subjekti në mënyrë të përsëritur pranon të ketë gabime dhe pasaktësi në deklarime, duke i konsideruar ato lapsuse;

➔ Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

➔ Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për pasuritë që ka në pronësi, mungesë të dokumentacionit ligjor për pronësinë e këtyre burimeve të pretenduara;

➔ Ka kryer fshehje të pasurisë në shuma të vogla;

➔ Ka kryer deklarim të rremë në mënyrë të përsëritur, duke u përpjekur të justifikojë veprimet e viteve të mëparshme me deklarata noteriale të sapohartuara.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" dhe në nenin 61, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit e rivlerësimit, Znj. Besa Nikëhasani, prokurore pranë Prokurorisë së Apelit Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE SUELA ZHEGU Kryesuese PAMELA QIRKO GENTA TAFA (BUNGO) Anëtare Relatore OLSIDA GOXHAJ Sekretare gjyqësore U shpall në Tiranë, më datë 20.04.2018.

Paraqesim kete kallzim penal per personat e sipercituar,pasi besojme se ligji eshte i barabarte per te gjithe qytetaret e ketij vendi,me shpresen se vetem zbatimi i ligjit me mbeshtetjen e partnereve tane nderkombetare si Shtetet e Bashkuara te Amerikes,dhe Bashkimi Europian,shqiptaret kane filluar te besojne sado pak tek drejtesia e re.

[shqiptarja.com]

Nje pjese e gjyqtarve te Gjykates se Larte dhe Kushtetuese te trajtuara ne kete kallzim penal,para fillimit te detyres ata jane betuar para presidentit te Republikes mbi kushtetuten e vendit,duke thyer solemnisht betimin,citojme Betim:

Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t'i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale!"

Nga ana e SPAK,kerkojme:

- Regjistrimin e fillimit te procedimit penal,ndaj personave te kallzuar penalisht,te identifikuar ne te gjitha Institucionet ligjezbatuese te vendit,dhe opinionit publik,duke kryer te gjitha veprimet hetimore te nevojshme per nje sqarim sa me te sakte te te gjitha rrethanave qe ne parashtruam me larte.Te gjithe ishe Prokuroret dhe Gjyqtaret.te kallzuar penalisht jane shkarkuar me fakte dhe prova,te provuara nga Komisioni i Pavarur te Kualifikimit(K.P.K),nga Komisioni i Pavaruar Apelimit(K.P.A)nga.Instituti i Komisionierit Publik(I.K.P),nga Operacioni Nderkombetare i Monitorimit(O.M.N),nga.Inspektoriati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurise,(I.L.D.K.P).

KALLZUESI

FRAN DASHI.
d.v

[shqiptarja.com]